



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/76  
Datë: 27.07.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 korrik 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhje: 71, 72, 73, 74 dhe 75 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THACI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/76

Datë: 27.07.2009


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 korrik 2009, mori

**V E N D I M**

1. Në fazën parë, ndahen mjetet financiare në vlerë prej 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) euro, për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga breshri në komunën e Gjilanit, sipas përlogaritjeve të komisionit për vlerësimin e dëmeve nga breshri.
2. Mjetet financiare sipas pikës 1. të këtij vendimi ndahen nga rezervat e qeverisë-shpenzime kapitale dhe barten në subvencione në komunën e Gjilanit, programi - kryetari dhe asambleja komunale (160).
3. Kuvendi Komunal i Gjilanit të autorizojë komisionin komunal për dëmet nga breshri për përcaktimin e prioriteteve sipas sektorëve dhe kategorive për përpilimin e listës së përfituesve potencialë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Kuvendi Komunal i Gjilanit.
5. T'i raportohet me shkrim Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

  
Hashim THACI  
Kryeministër i Kosovës



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/76

Datë: 27.07.2009


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 korrik 2009, mori

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Strategjisë Legjislative të vitit 2009 të Qeverisë së Republikës së Kosovës**

- 1) Në Strategjinë Legjislative të vitit 2009 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të përfshihen këto projektligje:
  - 1.1. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme (MTI);
  - 1.2. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L 123 për Shoqëritë Tregtare (MTI);
  - 1.3. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2004/36 për Konkurrencën (MTI);
  - 1.4. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-2 për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës (MPMS);
  - 1.5. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2004/42 për Veprimtarinë Kërkimore - Shkencore (MASHT);
  - 1.6. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-024 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (MMPH);
  - 1.7. Projektligji për Fondin për Mbrojtjen e Mjedisit (MMPH);
  - 1.8. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Doganave dhe Akcizave (MEF);
  - 1.9. Projektligji për Tatimin në Pronë (MEF);
  - 1.10. Projektligji për Banim Social (MPMS).

- 1.11. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë.
- 2) Nga Strategjia Legjislative e vitit 2009 të Qeverisë së Republikës së Kosovës hiqen këto projektligje:
- 2.1. Projektligji për Institutin Pedagogjik (MASHT);
  - 2.2. Projektligji për Institutin Albanologjik(MASHT);
  - 2.3. Projektligji mbi Ngrohjen Qendrore (MEM);
  - 2.4. Projektligji për Inspektoratin e Punës (MPMS);
  - 2.5. Projektligji për Organizimin e Institucioneve të Kadastrit në Republikën e Kosovës.
- 3) Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 4/2004 për Shëndetësi dhe Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Veprimtarin Private në Shëndetësi, bashkohen (fuzionohen) në Projektligjin për Shëndetësi (MSH).
- 4) Projektligji për Autopsitë riemërohet Projektligji për Mjekësinë Ligjore (MD).
- 5) Bartës i hartimit të Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 2003/12 për Qasje në Dokumente Zyrtare, është Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me MAP-in.
- 6) Zyra për Shërbimet e Ndihmës Juridike në Zyrën e Kryeministrit, në koordinim me departamentet ligjore të ministrive, rishikon dhe përfshin afatet kohore për hartimin e projektligjeve në Strategjinë Legjislative të vitit 2009, më së largu shtatë ditë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- 7) Ngarkohet Zyra për Shërbimet e Ndihmës Juridike në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
- 8) Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THACI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 04/76

Datë: 27.07.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 korrik 2009, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 18.000 (tetëmbëdhjetëmijë) euro për organizimin e manifestimit tradicional "Ditët e Mërgatës në Kosovë - 2009", i cili organizohet nën udhëheqjen e Zyrës për Çështje Jo-rezidente të Zyrës së Kryeministrit.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit, kodi buxhetor 81000.
3. Ngarkohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THACI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë